



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.182/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli, kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Subjekti Politik Nasa Bosnjacka Koalicija me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), numër 01-173/2025, të datës 21.01.2025, për Akreditimin e Grupit të Dytë të Vëzhguesve të partisë politike Koalicioni Vakati, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 27.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

Hedhet e pasafatshme ankesa Anr.182/2025 e datës 24.01.2025 parashtruar nga Subjekti Politik Nasa Bosnjacka Koalicija me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), numër 01-173/2025, të datës 21.01.2025, për Akreditimin e Grupit të Dytë të Vëzhguesve të partisë politike Koalicioni Vakati, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 24.01.2025, Nasa Bosnjacka Koalicija me seli në Prizren, ka paraqitur ankesë në PZAP, kundër vendimit Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në të cilin pretendohet se sipas regjistrimit të fundit, numri i Boshnjakëve në Republikën e Kosovës është 26,841, ndërsa numri i vëzhguesve të regjistruar vetëm nga Koalicioni Vakati arrin deri në 700, dhe kur merren parasysh subjektet tjera politike (Partia e Re Demokratike me 260, SDU me 102 dhe NBK me 28 vëzhgues), arrijmë në përfundimin se për çdo vëzhgues vijnë 24 boshnjakë.

Sipas parashtruesit të ankesës duke marrë parasysh numrin e votuesve të komunitetit boshnjak, i cili është rreth 12,000, vim deri te shifra edhe më shkatërruese që tregojnë keqpërdorimin e

dukshëm të sistemit të vëzhguesve për interesa politike. Ky trend është një kërcënim serioz për demokracinë, sepse cenon ekuilibrin dhe drejtësinë e procesit zgjedhor, si dhe themelet e vlerave demokratike. Vëzhguesit duhet të kenë rolin e garantimit të transparencës dhe rregullsisë së zgjedhjeve dhe jo të përdoren si mjet manipulimi politik.

Prandaj, mendojnë se është e nevojshme të vendoset një normë që do të kufizonte numrin e vëzhguesve, për tu parandaluar abuzime dhe manipulime të tilla. Gjithashtu, duke pasur parasysh se vëzhguesit financohen nga buxheti i partisë, është e nevojshme të kryhet kontroll financiar për të siguruar që fondet e përdorura për vëzhguesit të vijnë nga burime të ligjshme dhe të justifikuara. Bëjnë thirrje institucioneve kompetente që të shqyrtojnë arsyeshmërinë dhe ligjshmërinë e kësaj situate, në mënyrë që zgjedhjet të mbeten të lira, të ndershme dhe demokratike.

Si provë në ankesë kanë bashkangjitur listën zyrtare të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ku tregohen vëzhguesit e regjistruar për zgjedhjet e ardhshme.

PZAP, iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve KQZ, dhe në përgjigjen e tyre Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike, thekson se Koalicioni "Naša Bošnjačka Koalicija (Naša Inicijativa i Bošnjačka stranka) lidhur me numrin e vëzhguesve të akredituar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

Sipas vendimit të KQZ-së me numër 01-173/2025, të datës 21.01.2025, janë akredituar gjithsej 700 vëzhgues për të vëzhguar procesin zgjedhor për Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili do të mbahet më 9 shkurt 2025. Numri i vëzhguesve të akredituar, përkatësisht 700, është në emër të "Koalicija Vakati".

Duke u bazuar në neni 54 Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vëzhguesit mund të akreditohen vetëm në kuadër të organizatave vëzhguese, si: Subjektet politike të certifikuar, Organizatat jo qeveritare, Organizatat ndërkombëtare, Mediat, Përfaqësitë diplomatike në Kosovë, Institucionet qeveritare/ ndërqeveritare.

Subjektet Politike të Certifikuar mund të kenë vëzhgues të akredituar Jo më shumë se një (1) vëzhgues i subjektit politik të certifikuar, mund të vëzhgoje votimin në vendvotim, numërimin, paketimin dhe dorëzimin e materialeve, vlerësimin pakove me fletëvotime dërguara nga votuesit jashtë Kosovës.

PZAP, iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje Koalicionit Vakati, në të cilën kanë theksuar se duke u bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Kapitulli IX, nenet 54, 55, 56, 57 dhe 58, që kanë të bëjnë me vëzhguesit, nuk specifikohet se sa vëzhgues mund të angazhojë një parti politike.

Arsyeja e angazhimit të vëzhguesve nga Koalicioni Vakati është se Koalicioni Vakati ekziston në të gjitha komunat ku jetojnë boshnjakët, si përmes partive të Koalicionit ashtu edhe përmes degëve të partnerëve tanë politikë.

Arsye shtesë është se partitë kësaj radhe do të mund të punësojnë vëzhgues në të gjitha komunat ku do të numërohen votat individuale, për çka do të kemi nevojë për një numër më të madh vëzhguesish. Prandaj, besojmë se ankesa e paraqitur në panelin tuaj nuk ka bazë ligjore.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës së parashtruar nga ankuesi, gjeti se:

- Ankesa është e pasafatshme

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Naša Bošnjačka Koalicija (Naša Inicijativa i Bošnjačka stranka) kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), numër 01-173/2025, të datës 21.01.2025, për Akreditimin e Grupit të Dytë të Vëzhguesve të partisë politike Koalicioni Vakati, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 54 pika 8, ku është paraparë që çdo subjekt politik, organizatë, medium apo individ që ka aplikuar për akreditim për vëzhgues të procesit zgjedhor e që i është refuzuar akreditimi nga KQZ-ja, mund të parashtror ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve, pas vendimit për mosakreditim. PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, e në kuptim të neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, rezulton se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP, më datë 24.01.2025, ndërsa vendimi i goditur me ankesë është marr nga KQZ me datë 21.01.2025, prandaj duke u nisur nga fakti se afati për ankesë është afat prekluziv atëherë është dashur që ankesa të hedhet pasi që e njejtat siq u cek edhe me lart është parashtruar jasht afatit prej 48.


Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 54 pika 8 nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 59 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr.182/2025, datë 27.01.2025

Kryesuese e Panelit

Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.